



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.27

2004

10 maj

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9214 datë 1.4.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit"..... 1331
Vendim i KM nr.215, datë 16.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001, nr.358, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave", të ndryshuar. 1337
Vendim i KM nr.236, datë 23.4.2004	Për miratimin e uniformës dhe të shenjave të Policisë së Shtetit 1339
Vendim i KM nr.239, datë 23.4.2004	Për miratimin e rregullores së disiplinës së Gardës së Republikës të Shqipërisë 1346
Vendim i KM nr.241, datë 23.4.2004	Për një ndryshim e shtesë në vendimin nr.81, datë 6.2.2003 të Këshillit të Ministrave "Për shitje trualli Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë"..... 1354

Vendim i KM nr.242, datë 16.4.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Trajnimin e Nëpunësit Civil”.....	1356
Vendim i KM nr.243, datë 26.3.2004	Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore për vitin 2004 dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore	1357
Vendim i KM nr.244, datë 23.4.2004	Për miratimin e projektit pilot dhe të skemës së furnizimit me karburant pa akcizë, për përcaktimin e sasive të karburantit, që do të përdoren për mekanikën bujqësore në tri zona të vendit dhe për serat me ngrohje.....	1359
Vendim i KM nr.245, datë 16.4.2004	Për një shtesë fondi Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit për informatizimin e shërbimit të gjendjes civile	1360
Vendim i KM nr.246, datë 18.3.2004	Për lejimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë“, për shtypshkrimin e certifikatave të gjendjes civile, me elemente sigurie	1360
Vendim i KM nr. 247, datë 23.4.2004	Për miratimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit dhe të reformës institucionale në sektorin e pyjeve dhe të kullotave në Republikën e Shqipërisë	1361

LIGJ
Nr.9214, datë 1.4.2004

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË EKSTRADIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit", nënshkruar në Kajro më 2.4.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4211, datë 26.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT MBI
EKSTRADIMIN

Republika e Shqipërisë dhe Republika Arabe e Egjiptit, këtej e tutje të quajtura "Palët",
duke dëshiruar të zhvillojnë bashkëpunimin në çështje të gjyqësorit midis të dy vendeve,
duke njohur rëndësinë e përfundimit të Marrëveshjes për bashkëpunimin gjyqësor mbi
ekstradimin,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Detyrimi për të ekstraduar

Palët bien dakord të këmbejnë ekstradim të personave në territorin e tyre të cilët janë akuzuar ose dënuar nga gjyqësori i shtetit tjetër, në bazë të rregullave dhe kushteve të neneve vijuese.

Neni 2

Vepra të ekstradueshme

Ekstradimi do të ekzekutohet për:

a) Të gjitha veprat që përbëjnë vepra të dënueshme me privim të lirisë për të paktën një vit,
ose me një dënim më të rëndë.

b) Në varësi të paragrafit (a) të këtij neni, një vepër do të jetë vepër e ekstradueshme edhe nëse përbën një tentativë ose komplot, duke ndihmuar ose duke bashkëpunuar, ose duke qenë bashkëpunëtor para ose pas faktit, për kryerjen e një veprë të përshkruar në paragrafin (a).

c) Të gjitha dënimet e dhëna nga gjykata e shtetit kërkues, të krimeve të përshkruara në paragrafin (a) të këtij neni, me kusht që periudha e paraburgimit të mos jetë më pak se gjashtë muaj.

d) Për qëllimet e këtij neni, një vepër do të jetë vepër e ekstradueshme në mënyrë të pavarur, në rast se vepra specifikohet brenda së njëjtës kategori shkeljesh ose përshkruhet me të njëjtën terminologji sipas ligjeve të Palëve Kontraktuese.

e) Në rast se është pranuar ekstradimi për një vepër të ekstradueshme, ai do të pranohet edhe për çdo vepër tjetër të specifikuar në kërkesë, edhe pse vepra e fundit është e dënueshme me më pak se një vit privim lirie, me kusht që të përmbushen të gjitha kërkesat e tjera të ekstradimit.

Neni 3

Shkaqet e detyrueshme të mospranimit

Ekstradimi nuk do të pranohet:

a) Në rast se personi që kërkohet të ekstradohet është shtetas i shtetit të cilit i bëhet kërkesa; shteti të cilit i bëhet kërkesa, nëse e kërkon shteti tjetër, ua përcjell çështjen autoriteteve kompetente të tij dhe shfrytëzon hetimet e kryera nga shteti kërkues.

b) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi është krim politik ose e lidhur me një krim politik në shtetin të cilit i bëhet kërkesa.

Megjithatë, sulmi kundër jetës së presidentëve të shtetit ose ndonjëres prej familjeve të tyre, si dhe veprat terroriste, nuk do të konsiderohen krime politike.

c) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi është vepër në bazë të ligjit ushtarak.

d) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi, është kryer tërësisht ose pjesërisht në shtetin të cilit i është bërë kërkesa ose në juridiksionin e tij.

e) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi, jepet nga një gjykim përfundimtar ose një urdhër për vazhdimin e çështjes, ose mund të jetë i anulueshëm.

f) Në rast se për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi çështja penale ka përfunduar ose dënimi është dhënë sipas ligjit të shtetit kërkues në kohën e marrjes së kërkesës.

g) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi fiton imunitet ndaj procedimit ose dënimit për shkak amnistie sipas secilit shtet.

Neni 4

Shkaqe alternative për mospranim

Ekstradimi mund të mos pranohet:

1) Në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa ka motive thelbësore për të besuar se dënimi i mundshëm i veprës në shtetin kërkues është cilësisht i ndryshëm nga dënimi i mundshëm i dhënë për të njëjtën vepër në gjykatat e shtetit të cilit i është bërë kërkesa.

2) Në rast se personi i kërkuar është shpallur fajtor në mungesë, autoritetet kompetente të vendit të cilit i është bërë kërkesa mund të mos e pranojnë ekstradimin, në rast se shteti kërkues nuk i jep shtetit tjetër informacionin që demonstroi që personit i është ofruar mundësi e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

3) Ekstradimi nuk pranohet në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa ka motive materiale për të besuar se kërkesa për ekstradim është bërë me qëllim ndjekjen ose dënimin e një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, të drejtave politike dhe kushtetuese të atij personi, ose që pozita e personit në fjalë mund të paragjykohej për ndonjërin prej këtyre arsyeve.

Neni 5

Kanalet e komunikimit dhe dokumentet e kërkuara

1) Një kërkesë për ekstradim duhet të bëhet me shkrim dhe të transmetohet përmes kanaleve diplomatike.

2) Një kërkesë për ekstradim duhet të shoqërohet si më poshtë me:

a) origjinalin ose një kopje të vërtetuar të vendimit ose masës së arrestit, sipas rrethanave të përcaktuara në ligjin e shtetit kërkuar;

b) deklaratë përmbledhëse të veprave për të cilat kërkohet ekstradimi, duke shpjeguar kohën dhe vendin e kryerjes së tyre, karakterizimin, si dhe nenet përkatëse mbi të cilat vepra në fjalë është e dënueshme;

c) një përshkrim sa më të saktë të personit të kërkuar, së bashku me çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë në përcaktimin e identitetit dhe kombësisë së tij.

3) Me përjashtim të rasteve kur kjo marrëveshje parashikon ndryshe, procedurat në lidhje me ekstradimin dhe arrestin paraprak do të udhëhiqen vetëm nga ligji i shtetit që i kërkohet ekstradimi.

Neni 6

Pranueshmëria e dokumenteve

Dokumentet në mbështetje të një ekstradimi do të merren dhe do të pranohen si dëshmi në procedurat e ekstradimit. Dokumentet duhet të jenë të vërtetuara nga një gjyqtar, magjistrat ose punonjës gjyqësor si dokumentet origjinale ose kopjet e vërteta, dhe do të vërtetohen edhe me vulën zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë

Neni 7

Arrestimi i përkohshëm

1. Në rast urgjence, gjyqësori i shtetit kërkuar mund të bëjë kërkesë për arrestim të përkohshëm të një personi.

2. Është e nevojshme që kërkesa për arrestimin e përkohshëm të përfshijë njërin prej dokumenteve të përmendura në paragrafin 2-a në nenin 5, një deklaratë të veprës së kryer, kohëzgjatjen e masës së dënimit të shpallur ose të dhënë, duke treguar kohën dhe vendin ku u krye, si dhe të jepet informacion sa më i hollësishëm e i disponueshëm, që do të ndihmojë në identitetin dhe vendndodhjen e personit në fjalë.

3. Arrestimi i përkohshëm i përcillet gjyqësorit të shtetit të cilit i bëhet kërkesa drejtpërdrejt me postë ose telegram, ose me regjistrim tjetër me shkrim.

4. Në rast se kërkesa zbatohet me përpikëri, gjyqësori i shtetit të cilit i është bërë kërkesa do ta ekzekutojë kërkesën siç parashikohet në ligjin e tij dhe do t'ia komunikojë menjëherë vendimin e tij shtetit kërkuar.

Neni 8

Arrestimi i përkohshëm

1. Arrestimi i përkohshëm mund të ndërpritet në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa nuk e ka marrë kërkesën dhe dokumentet e specifikuar në paragrafin 2 të nenit 5 brenda tetëmbëdhjetë (18) ditëve nga data e arrestimit, që do të shtrihet deri ditën e parë të punës, nëse dita e fundit është ditë pushimi kombëtare.

2. Në të gjitha rastet, arrestimi i përkohshëm nuk do të kalojë një periudhë (40) dyzet ditore nga data e arrestimit.

3. Shteti të cilit i është bërë kërkesa mund të lirojë përkohësisht në çdo kohë personin e kërkuar dhe të marrë të gjitha masat që të mos e lejojë atë të arratiset jashtë territorit.

4. Lirimi i personit nuk ndalon riarrestimin ose ekstradimin e atij personi, nëse pas kësaj merret kërkesa për ekstradimin. Në të gjitha rastet koha e kaluar në ndalim do të përfshihet në masën e dënimit.

Neni 9 **Informacioni shtesë**

Në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa mendon se informacioni i dhënë në mbështetje të kërkesës së ekstradimit nuk është i mjaftueshëm, ai mund t'i kërkojë shtetit kërkues përmes kanaleve diplomatike të tij të japë informacionin shtesë brenda një kohe të arsyeshme, siç specifikohet prej tij.

Neni 10 **Kërkesat e njëkohshme**

Në rast se ekstradimi kërkohet njëkohësisht nga më shumë se një shtet për të njëjtën veprë ose për vepra të ndryshme, shteti të cilit i është bërë kërkesa do ta marrë vendimin e tij lirisht duke pasur parasysh të gjitha rrethanat veçanërisht kombësinë, mundësinë e ekstradimit të ndërsjellë të mëvonshëm, datën e marrjes së kërkesave, masën e rëndesës së krimit, vendin e kryerjes së krimit dhe të personit të kërkuar.

Neni 11 **Sekuestrimi dhe dorëzimi i objekteve**

1. Pa paragjykuar të drejtat e tij dhe të drejtat e palës së tretë dhe në varësi të së drejtës penale të tij dhe me kërkesë të shtetit tjetër, shteti të cilit i është bërë kërkesa do të sekuestrojë dhe do të dorëzojë sa më poshtë:

- a) objektet që përbëjnë prova, që kanë të bëjnë me krimin subjekt i dorëzimit,
- b) objektet që janë të ardhura nga krimi, që janë gjetur para dhe pas ekstradimit,
- c) objektet që janë siguruar si kthim për të ardhurat nga krimi.

2. Objektet mund të dorëzohen edhe nëse personi i kërkuar nuk mund të ekstradohet për shkak të arratisjes ose vdekjes së tij, në rast se nuk nevojiten për procedurat penale në shtetin të cilit i është bërë kërkesa.

3. Në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa ose ndonjë palë tjetër e tretë ka fituar të drejta mbi objektet e mësipërme, këto objekte do t'i kthehen shtetit të cilit i është bërë kërkesa sa më shpejt që të jetë e mundur pa tarifë pas përfundimit të procedurave në territorin e shtetit kërkues, në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa ose ndonjë palë tjetër e tretë nuk heq dorë nga e drejta e zotërimit të tyre.

4. Shteti të cilit i është bërë kërkesa mund të dorëzojë pasurinë me kushtin e sigurimeve të kënaqshme nga shteti kërkues që kjo pasuri do t'i kthehet shtetit të cilit i është bërë kërkesa sapo që të shihet e arsyeshme. Shteti të cilit i është bërë kërkesa mund edhe të shtyjë dorëzimin e kësaj pasurie në rast se ajo nevojitet si provë në shtetin të cilit i është bërë kërkesa.

Neni 12 **Vendimi mbi kërkesën**

1. Përmes kanaleve diplomatike, shteti të cilit i është bërë kërkesa do të njoftojë shtetin kërkues për vendimin e tij për ekstradimin.

2. Arsytet e vendimit të mospranimit do të deklarohen plotësisht ose pjesërisht.

3. Në rast pranimi shteti të cilit i është bërë kërkesa përcakton mënyrën, vendin dhe datën më të përshtatshme për ekzekutimin e ekstradimit.

4. Në varësi të rastit të përmendur në paragrafin 5 të këtij neni, personi që do të ekstradohet mund të lirohet pas 15 ditësh nga data e caktuar në rast se ky person nuk është ekstraduar në datën për të cilën është rënë dakord. Në të gjitha rastet, personi që do të ekstradohet do të lirohet pas 30

ditësh nga data e caktuar dhe në këtë rast shteti të cilit i është bërë kërkesa mund të mos e pranojë ekstradimin për të njëjtën vepër.

5. Në rast se ekstradimi i personit të kërkuar pengohet për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, pala e interesuar njofton palën tjetër për këto rrethana para kalimit të datës së caktuar. Të dy shtetet bien dakord për një datë tjetër dhe, nëse kërkohet, një vend të ri ekstradimi. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e paragrafit pararendës.

Neni 13

Dorëzimi i përkohshëm dhe i shtyrë

1. Në rast se personi që do të ekstradohet është akuzuar ose dënuar në shtetin të cilit i është bërë kërkesa për një vepër të ndryshme nga vepra për të cilën kërkohet ekstradimi, shteti të cilit i është bërë kërkesa merr vendimin e tij dhe njofton shtetin kërkues, në bazë të kushteve të paragrafit 1 dhe 2 të nenit 12. Në rast pranimi, ekstradimi i personit të kërkuar do të shtyhet deri në gjykimin e tij në shtetin të cilit i është bërë kërkesa. Ekstradimi do të ekzekutohet në një datë të caktuar sipas dispozitave të paragrafit 3 të nenit 12. Zbatohet edhe dispozitat e paragrafit 4 dhe 5 të të njëjtit nen.

2. Dispozitat e këtij neni nuk e pengojnë mundësinë që personi i kërkuar për t'u ekstraduar të paraqitet për një periudhë të caktuar kohe para autoriteteve gjyqësore në shtetin kërkues, me kusht që personi të vazhdojë të mbahet i ndaluar dhe të kthehet pas marrjes së vendimit të këtyre autoriteteve.

Neni 14

Rregullimi i veçantisë

Personi i ekstraduar nuk mund të procedohet, as të ndalohet, as të kufizohet në lirinë e tij vetjake në çfarëdo mënyre për një vepër të kryer para dorëzimit të tij dhe të ndryshme nga ajo për të cilën ai u ekstradua, përveçse në rastet e mëposhtme:

a) Në rast se shteti dorëzues bie dakord për këtë, me kusht që të bëhet një kërkesë në lidhje me këtë dhe kjo t'u bashkëngjitet dokumenteve të parashikuara në nenin 5 dhe dosjes gjyqësore ku të përfshihet deklarata e personit të ekstraduar mbi shtyrjen e ekstradimit, dhe duke iu referuar faktit që personi në fjalë të kishte mundësinë të mbrohej para autoriteteve të shtetit.

b) Kur personi, pasi të ketë pasur mundësinë për t'u larguar nga territori i shtetit të cilit iu dorëzua dhe nuk ka ekzekutuar brenda 45 ditëve të lirimit të tij të fundit ose është kthyer në atë territor pas largimit prej tij.

c) Në rast se personi i kërkuar, nëpërmjet një garancie ose ndryshe, pranon zyrtarisht t'i dorëzohet shtetit kërkues, shteti dorëzues mund ta dorëzojë personin sa më shpejt që të jetë e mundur pa procedura të tjera.

Neni 15

Ekstradimi në një shtet të tretë

Përveçsa përmendet në nenin 14, paragrafi (b), për ta lejuar shtetin kërkues që ta ekstradojë të ekstraduarin në një shtet tjetër do të kërkohet miratimi i shtetit të cilit i është bërë kërkesa. Për këtë qëllim, shteti kërkues i bën një kërkesë shtetit të cilit i është bërë kërkesa duke i bashkëngjitur asaj një kopje të dokumenteve të paraqitura nga shteti i tretë.

Neni 16

Karakterizimi ligjor

Në rast se karakterizimi ligjor i procesit në varësi të veprës është modifikuar gjatë procesit të ndërmarrë kundër personit të dorëzuar, ai nuk mund të akuzohet ose të procedohet në rast se elementet që përbëjnë krimin, sipas karakterizimit të modifikuar të tyre, nuk e lejojnë ekstradimin.

Neni 17

Transiti

1. Me marrjen e kërkesës përmes kanaleve diplomatike ose ndonjë mjeti tjetër të përmendur në nenin 20 të kësaj Marrëveshjeje, të dyja Palët Kontraktuese do të pranojnë kalimin e personit të ekstraduar tek secili prej tyre nga një shtet i tretë përmes ndonjërit prej territoreve. Kërkesa e mësipërme do të shoqërohet me dokumentet e nevojshme që provojnë se kjo çështje është e lidhur me një krim që mund të çojë në ekstradim. Megjithatë, në rast se personi që do të transferohet është shtetas i shtetit të cilit i është bërë kërkesa, kjo kërkesë kalimi mund të mos pranohet.

2. Në rast përdorimi të linjave ajrore, do të zbatohen këto dispozita:

a) Kur nuk kërkohet ulja e avionit, shteti kërkues njofton shtetin nëpër hapësirën e të cilit do të bëhet kalimi, për ekzistencën e dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2 (a) neni 5. Në rast uljeje për shkak të një situatë të jashtëzakonshme, ky njoftim do të ketë efektet e një kërkesë për ruajtje të përkohshme të përmendur në nenin 7 dhe shteti kërkues duhet të bëjë një kërkesë kalimi të zakonshme.

b) Në rast se kërkohet ulja e avionit, shteti kërkues bën një kërkesë kalimi sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni.

c) Në rast se shteti të cilit i është kërkuar lejkalimi kërkon edhe ekstradimim e personit në fjalë, kalimi i personit mund të shtyhet deri se gjyqësori i këtij shteti të përfundojë procedimin e personit në fjalë.

Neni 18

Shpenzimet

1. Shteti të cilit i është bërë kërkesa do të mbulojë të gjitha shpenzimet sipas juridiksionit të tij që lindin nga procedurat e ekstradimit.

2. Shteti kërkues mbulon të gjitha shpenzimet e kryera për kalimin e personit nëpër territorin e shtetit të cilit i është bërë kërkesa.

Neni 19

Gjuha

Kërkesat dhe dokumentet e bëra në zbatim të këtij traktati do të shoqërohen me një përkthim në gjuhën e shtetit të cilit i është bërë kërkesa ose në gjuhën angleze.

Neni 20

Autoritetet kompetente

Për qëllimet e këtij traktati, autoritetet kompetente do të përcjellin dhe do të marrin të gjitha kërkesat dhe përgjigjet ndaj tyre. Autoriteti kompetent për Republikën e Shqipërisë do të jetë Ministria e Drejtësisë.

Për Republikën Arabe të Egjiptit do të jetë Departamenti i Përgjithshëm i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Kulturor pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 21

Koha e zbatimit

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për shkelje të kryera para dhe pas datës së saj në fuqi.

Neni 22

Dispozitat përfundimtare

Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të saj, termi i autoriteteve gjyqësore do të përfshijë gjykatat dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 23

Çdo vështirësi që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i traktatit do të zgjidhet përmes negociatave ose me Ministrinë e Drejtësisë, ose përmes kanaleve diplomatike.

Neni 24

Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave kushtetuese të kërkuara nga ligjet përkatëse të tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të mësipërm të kërkuar në këtë nen.

Neni 25

Kjo Marrëveshje do të mbesë në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe. Megjithatë, çdo palë mund ta ndërpresë Marrëveshjen në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së zbatuari një vit pas datës së marrjes së njoftimit të mësipërm nga pala tjetër.

Në prani të njëri-tjetrit, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar për këtë nga qeveritë përkatëse të tyre, firmosën këtë Marrëveshje.

Bërë në Kajro, më 2.4.2002 në tri (3) kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht, ku të gjitha kopjet janë njësoj/barasvlefshëmrisht autentike dhe në rast mosmarrëveshjes në interpretim, kryesore do të jetë kopja në anglisht.

VENDIM

Nr.215, datë 16.4.2004

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE TË KUVENDIT DHE DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.39, DATË 26.1.2001, NR.158, DATË 22.3.2001, NR.167, DATË 30.3.2001, NR.174, DATË 30.3.2001, NR.197, DATË 6.4.2001, NR.358, DATË 31.5.2001 DHE NR.424, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës "5" shtohet pika "5/1", me këtë përmbajtje:

"5/1 "Specialistët" apo "përgjegjësit e sektorit" në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme arsimin e lartë, në degët "inxhinieri elektronike" apo "informatikë", përfitojnë një shtesë për "kushte

pune" prej 15 000 lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Ministrisë së Financave dhe të Departamentit të Administratës Publike, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës."

b) Pas pikës "6" shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

"6/1 Kategorizimi për funksionet e veçanta është sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij."

c) Në shkronjën "a", të pikës 7, emërtesa "shef kabineti i ministrit" zëvendësohet me "drejtor i kabinetit të ministrit".

ç) Pika 11, shfuqizohet.

2. Efektet financiare për këtë vit të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për institucionet përkatëse.

3. Vendimi nr.348, datë 27.6.2002 i Këshillit të Ministrave "Për kategorizimin e pozicioneve të punës së nëpunësve civilë në aparatin e Këshillit të Ministrave", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LIDHJA NR.3

KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS

Institucioni	Pozicioni	Kategoria e pagës
Kryeministria	Drejtor i Njesisë së Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	II-a
	Drejtor i Njesisë Antikorrupsion	II-a
	Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm	II-b
	Jurist në Departamentin Juridik	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ	II-b
	Koordinator në Departamentin e Zhvillimit të Politikave dhe Koordinimit	II-b
	Përgjegjës sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Njësine të Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	III-a
Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale	Drejtor i Inspektoratit Shtetëror të Punës	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Përfaqësues i Zyrës së Minoriteteve	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtoritë e Auditimit të Brendshëm apo sektorët e Auditimit të Brendshëm	III-b

VENDIM
Nr. 236, datë 23.4.2004

PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e uniformës dhe të shenjave të Policisë së Shtetit, sipas albumit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Llojet e uniformës së punonjësve të Policisë së Shtetit janë:

- a) Uniforma në detyrë bazë I, përbërja stof teritali;
- b) Uniforma e shërbimit bazë II, përbërja dok terikoton e poliestër;
- c) Uniforma verore, përbërja pambuk, poliestër e viskozë;
- ç) Uniforma e stërvitjes dhe e kohës së luftës, e njëjtë me uniformën e përcaktuar në shkronjën "b";

d) Uniforma ceremoniale, e njëjtë me uniformën e përcaktuar në shkronjën "a", por me elemente e shtesa të tjera veshjeje për plotësimin e kësaj uniforme.

Llojet e këpucëve të punonjësve të Policisë së Shtetit janë:

- a) Këpucë gjysma për uniformën në detyrë, për meshkuj e femra, verore dhe dimërore, me lëkurë natyrale (boks viçi), në ngjyrë të zezë;
- b) Këpucë me qafa trup për uniformën e shërbimit dhe të stërvitjes, me lëkurë natyrale (varqet tip "U"), në ngjyrë të zezë dhe me ngjitje.

2. Ministri i Rendit Publik miraton:

- a) rregulloren e uniformës së punonjësve të Policisë së Shtetit;
- b) normat e materialeve të veshmbathjes, që janë në inventar të komisariateve dhe të reparteve;
- c) normat e furnizimit me veshmbathje të punonjësve të Policisë së Shtetit;
- ç) normat e furnizimit me veshje civile të punonjësve të Policisë Kriminale ose të konvertimit të tyre në vlerë në lekë;
- d) zëvendësimet e materialeve të veshmbathjes, brenda vlerës së normës;
- dh) normat e materialeve të konsumit dhe të mirëmbajtjes;
- e) normat e pajisjeve për qentë e policisë;
- ë) normat e veshmbathjes së posaçme dhe të rrobave të punës, falas;
- f) uniformat e shërbimeve të veçanta të policisë (qarkullim rrugor, helikopter, mjete lundruese, zhytësa, antiexploziv etj.) dhe pajisjet speciale të tyre;
- g) shenjat dalluese sipas shërbimeve të policisë, ornamentet dekorative e shtesa të tjera veshjeje për plotësimin e uniformës ceremoniale, me përjashtim të shenjës që vendoset në pjesën ballore të kapeles, shenjave të gjoksit, sipas roleve, gradave, stemës dhe simbolit të flamurit të Policisë së Shtetit;
- gj) ndryshimet e mundshme në elementet e veçanta të uniformës ekzistuese dhe të uniformës së ndryshuar të punonjësve të Policisë së Shtetit;
- h) përdorimin, sipas nevojave, të objekteve të uniformës ekzistuese dhe të uniformës së ndryshuar të punonjësve të Policisë së Shtetit.

3. Uniforma e Policisë së Shtetit mbahet vetëm nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i tyre për përdorues të institucioneve të tjera, që trajtohen me uniformë. Përdorimi i objekteve të uniformës së policive të tjera që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat janë të njëjta me ato të punonjësve të Policisë së Shtetit, të vazhdojnë deri në datën 31.12.2005.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

5. Vendimet nr.550, datë 8.11.1993 "Për normat e veshmbathjes së studentëve të Akademisë së Rendit", nr.332, datë 2.6.1998 "Për miratimin e uniformës dhe të stemës së policisë", nr.333, datë 2.6.1998 "Për miratimin e normës së veshmbathjes për policinë" dhe nr.629, datë 24.12.1999 "Për miratimin e normës së veshmbathjes për Forcat Speciale dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë" të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SPECIFIKIMET TEKNIKE

A. UNIFORMA BLU NË DETYRË BAZË I

1. Veshja normale (për periudhën 1 tetor - 31 mars) përfshin:

Kostum blu (xhakëtë, pantallona, kapele) me tekstil (stof teritali) të tezgjahuar, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, me përzierje 45 ± 3 për qind lesh dhe 55 ± 3 për qind poliestër, me këtë përshkrim:

a) *Xhaketa* është monopet dhe e çarë nga mbrapa. Ka dy xhepa të vegjël përpara në gjoks. Ato janë pllakë, me rrumbullakësi nga poshtë e kufo dhe me kapakë xhepi në formë harqesh. Ka dy xhepa të mëdhenj poshtë, ato janë pllakë me rrumbullakësi e kufo dhe me kapakë xhepi në formë harqesh. Kapakët e xhepave dhe nga përpara xhaketa (në sallki), e në mëngë kanë të vendosur kopsa të vogla e të mëdha plastike ngjyrë të "artë", me punime artistike. Kopsa nga brenda ka figurën e shqiponjës së stemës të Policisë së Shtetit dhe me mbishkrimet rrethuese me germa kapitale fjalët "POLICIA E SHQIPËRI". Në supet e xhakëtës vendosen spalina për vendosjen e gradave. Mbas kopsës së tretë poshtë mëngëve, sa largësia midis kopsave, vendosen dy filetot, një të kuq e një blu të hapur, nga 8-10 mm të gjera secila, që përfaqësojnë ngjyrat e simbolit të flamurit të Policisë së Shtetit.

b) *Pantallonat* kanë dy xhepa të pjerrëta para me fileto 3m/m, kanë një xhep mbrapa me fileto dhe me kapak në formë harku në anën e djathtë. Poshtë xhepave përpara, në rafinë anësore në gjatësinë e pantallonave duke filluar poshtë xhepit, vendosen dy fileta, një e kuqe e një blu e hapur, nga 8-10 mm të gjera secila, që përfaqësojnë ngjyrat e simbolit të flamurit të Policisë së Shtetit. Pantallonat janë me qemer të gatshëm, në sallki u vendoset për mbërthim zinxhir konfeksioni dhe kapse metalike.

c) *Kapelja* përbëhet nga tri pjesë: tepeleku, katër urat me të njëjtin stof dhe qemerët. Rreth e qark tepelekut dhe në të dyja anët rrethore të qemerit vendosen shirit në ngjyrë të "artë" me gdhendje të imëta. Sa madhësia e stofit që përdoret, poshtë tepelekut vendoset material special, si veti kryesore që lejon depërtueshmërinë e mjaftueshme të ajrit dhe të avujve. Streha për kapele është e ndërtuar me një karton prespan (të presuar) me trashësi 2,5 mm, e mbuluar në pjesën e sipërme me një fletë P.V.C. të zezë, të lëmuar dhe të shkëlqyeshme. Pjesa e përparme e strehës është e përfunduar me një bordurë plastike të përthyer dy herë dhe e qepur nga të dyja anët deri në pjesën ekstreme të strehës. Streha është në formë gjysmëhëne, ku harku i brendshëm që lidhet me kapelen është me rreze rreth 30-240 mm, nga ku del masa 205 mm. Pjesa e përparme është në formë kurbe, e cila në qendër ka një distancë 56-57 mm nga harku i mëparshëm, duke i afruar ekstremitetet e strehës deri në zero me harkun e parë. Në pjesën e sipërme të strehës për të gjitha rolet është aplikuar një kurorë me gjashtë fletë të stilizuar me PVC me ngjyrë të "artë", të gdhendur si të jenë qëndisje në relief, të cilat bëjnë orientimin e strehës në një formë kurbe, e cila shkon në të dyja anët në mënyrë të barabartë. Të gjitha fletët janë të mbuluara me një fletë plastike të tejdukshme mbrojtëse, e cila e mbron nga humbja e ngjyrave në prezencën e agentëve atmosferikë. Përmasat e fletëve të stilizuara kanë përmasa variable. Ato janë të barabarta dy e nga dy dhe duke nisur nga qendra arrijnë në drejtim të anëve. Respektivisht, kanë përmasat: gjatësi maksimale prej 53, 38, 35 mm dhe gjerësi maksimale prej 21, 18, 17 mm.

Në funksion të hierarkisë sipas roleve, aplikimi i kurorës me ngjyrë të "artë" në strehën e kapeles paraqitet me këtë shkallëzim:

- *Kapelja e rolit bazë*. Përveç gjashtë fletëve (kurorë) të stilizuara të vendosura në strehë, në gjysmën e qemerit të kapeles vendoset shirit gjatësor "ari" plastik, i zbukuruar në relief me tre shirita të vijëzuar ngjyrë blu. Shiriti në kapele montohet me kopsa të vogla plastike në formën e një ylli (rreze) të stilizuar në ngjyrë të "artë".

Nga brenda, në të dyja anët, shiritit mbas kopsave sa gjerësia e shiritit gjatësor i vendosen shirita në forma tubolare, që përfaqësohet me dy shirita ngjyrë "të artë" me gjerësi 4-5 mm dhe tre shirita ngjyrë blu me gjerësi 2 mm që janë me gdhendje dhe punime artistike.

- *Kapelja e rolit të mesëm*. Përveç gjashtë fletëve (kurorë) të stilizuara të vendosura në strehë, në qendër të strehës midis fundit të qemerit dhe gjashtë fletëve vendosen dhe dy fletë të tjera të stilizuara. Dhe kjo kapele në gjysmën e qemerit ka të vendosur shirit gjatësor "ari" plastik, i zbukuruar në relief me tre shirita të vijëzuar ngjyrë blu. Shiriti në kapele montohet me kopsa të vogla plastike në formën e një ylli (rreze) të stilizuar ngjyrë të "artë". Nga brenda, në të dyja anët, shiritit mbas kopsave sa gjerësia e shiritit gjatësor i vendosen shirita në formë tubolare, që përfaqësohet me tre shirita ngjyrë të "artë" me gjerësi 4-5 mm dhe katër shirita ngjyrë blu me gjerësi 2 mm, që janë me gdhendje dhe punime artistike.

- *Kapelja e rolit të lartë*. Përveç gjashtë fletëve (kurorë) të stilizuara, të vendosura në qendër të strehës midis fundit të qemerit dhe gjashtë fletëve, vendosen dhe katër fletë të tjera të stilizuara. Kapelja në gjysmën e qemerit ka të vendosur shirit gjatësor "ari" plastik i zbukuruar në relief me tre shirita të vijëzuar ngjyrë blu. Shiriti në kapele montohet me kopsa të vogla plastike në formën e një ylli (rreze) të stilizuar ngjyrë të "artë". Nga brenda, në të dyja anët, shiritit mbas kopsave sa gjerësia e shiritit gjatësor i vendosen shirita në formë tubolare që përfaqësohet me katër shirita ngjyrë të "artë" me gjerësi 4-5 mm dhe pesë shirita ngjyrë blu, që janë me gdhendje dhe punime artistike.

- *Kapelja e rolit drejtues*. Përveç gjashtë fletëve (kurorë) të stilizuara të vendosura në qendër të strehës midis fundit të qemerit dhe gjashtë fletëve vendosen dhe gjashtë fletë të tjera të stilizuara. Dhe kapeleve të këtyre roleve në gjysmën e qemerit u vendoset shirit gjatësor "ari" plastik i zbukuruar, kopsa të vogla tip ylli (rreze) të njëjtë me tri kapelet e roleve të lartpërmendura, por me ndryshimin se shiriti gjatësor, duke filluar nga brenda në të dyja anët e kopsave ka të vendosur shirita në formë tubolare që përfaqësohet nga 30 shirita ngjyrë të "artë" me gjerësi 4-5 mm dhe 31 shirita ngjyrë blu, nga të cilët: 23 shirita blu me gjerësi 2 mm dhe 8 shirita me gjerësi 4-5 mm. Shiritat janë me gdhendje e punime artistike.

Në përmblyllje të objektit kostum blu policie, materialet e tjera të përshtatshme që përdoren për sigurimin e cilësisë në prodhimin e tyre janë: astar mëndafshi, kanavacë e merle (ngjitës special) të përshtatshëm për pjesën e gjoksit të xhaketës, frazelinë, shirit ngjitës e zeqe, vata, zinxhir konfeksioni, qemer i gatshëm e materiale të brendshme për kapele, si: karton, tekstil igelit, fortesë, tub plastik etj.

2. *Këmisha me mëngë të gjata*, me tekstil (puplinë) të tezgjahuar, ngjyrë bojë qielli, cilësia e parë, me përzierje 67 ± 3 për qind poliestër dhe 33 ± 3 për qind pambuk me këtë përshkrim:

Këmishët janë me jaka të mbyllura, me bordurë (muzhik) në të gjithë gjatësinë përpara të përparësës (në anën e vrimave të vendosjes së kopsave) të përshkruara me tegela. Këmishët kanë dy xhepa pllakë përpara, me cepa të prerë në të dyja anët poshtë, ku xhepi i krahut të majtë është më i madh se xhepi i krahut të djathtë prej 3-4 cm në gjerësi, për të vendosur mjete shkruese dhe nuk mbulohet plotësisht nga kapaku i xhepit. Xhepat janë me kufo në mes dhe me kapak xhepi në formë harku. Mëngët e gjata janë me kapak. Këmishëve në përparësen e djathtë dhe në kapak të xhepave u qepen kopsat e vogla plastike ngjyrë "ari" me punime artistike, të cilat nga brenda kanë figurën e shqiptonjës së stemës së policisë me mbishkrimet rrethuese me germa kapitale fjalët "POLICIA E SHTETIT-SHQIPËRI". Pjesa e shpinës së këmishës është me supanjë dycopëshe dhe me penca anësore në vijën e qepjes. Nga përpara këmishët, në të dyja anët e përparses dhe në mënyrë të baraslarguar duke filluar nga buza e qepjes së supit përmes xhepave në kufo e deri në fund përshkruhen nga një tegel zbukurimi në formë zinxhiri. Jakave dhe kapakëve të mëngëve u vendosen kollaritje e plotë, ndërsa në spalinat dhe kapakëve të xhepave u vendoset frazelinë me ngjitje.

3. *Kravatë* me tekstil (pëlhurë) të tezgjahuar, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, 100 % poliestër, me këtë përshkrim:

Kravata është me kokë të paçmontueshme. Mbas lidhjes, duke filluar nga buza e lartë e kokës, gjatësia e përfunduar e saj shkon 48 cm. Të dyja brinjët e trekëndëshit poshtë kravatës janë të barabarta. Kravata është e ildisur dhe i vendoset frazelinë me ngjitje dhe kanavacë. Në mes, 4-5 cm poshtë buzës së kokës së kravatës, vendoset me qëndisje në relief stema në formën e një mburoje me përmasa 1,8 X 2,5 cm. Pjesa e sipërme e kësaj steme është e drejtë, ndërsa pjesa e poshtme është në formë ovale. Fusha është me ngjyrë të kuqe dhe në mes është vendosur figura e shqiponjës së stemës së Policisë së Shtetit me ngjyrë "ari". Kjo stemë në përmasat e saj konturohet me një kornizë në relief me ngjyrë "ari" të vijëzuar.

Objektet e veshmbathjes shtesë që vishen me uniformën blu në detyrë të punonjësit të Policisë së Shtetit janë:

4. *Xhakavento blu sintetike*, me veshje të ngrohtë, me tekstil të gomuar (pëlhurë impermeabël), 100% poliamid, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, me këtë përshkrim:

Xhakaventoja është njëcopëshe me kapuç, me dy xhepa të mëdhenj pllakë me kapak, me një vrimë më mes që mbërthehet me buton. Në anën e majtë të përparësës ka të qepur një sallki në të gjithë gjatësinë e saj, ku vendosen 5 copë butona mashkull dhe në krahun e djathtë vendosen 5 copë butona femër. Shpina është dycopëshe me qepje. Te beli rreth 30 cm i vendosen 3 llastika me tunel deri në mostër, nga ku del një lidhëse e gërshetuar në formë kordoni me një nyje në të dyja anët dhe u vendoset nga një kapëse lëvizëse për t'u fiksuar në përdorim. Në pjesën e sipërme të shpinës dhe përparësës vendoset një supanjë, e cila qepet në gavaturën e jakës dhe në mostër. Supanja e lirë kapet me ponto në katër cepat e saj dhe në supet. Te supet vendosen spalina me material velkro mashkull-femër për montimin e gradave. Mëngët janë tricopëshe me spalina dhe me butona. Veshja e ngrohtë është material llutër (pellush), është me dy përparëse dhe një shpinë dhe, duke filluar nga mesi i gavaturës, në shpinë, e gjatë mostrave në çdo 10 cm vendosen nga një eliqkë për mbërthim kopsash në mënyrë që veshja e ngrohtë të çmontohet për t'u vendosur në xhakaventon terikoton. Materiale të tjera të përshtatshme që përdoren për sigurimin e cilësisë në prodhimin e xhakaventove janë: astar mëndafshi, vatinë, ekstrafor, zinxhir konfeksioni etj.

5. *Xhakavento dok terikoton*, me tekstil (dok terikoton), i tezgjahuar, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, me përzierje 67 ± 3 % poliestër dhe 33 ± 3 % pambuk, me këtë përshkrim:

Xhakaventoja është njëcopëshe me dy xhepa pllakë me kapak në përparëse (pjesa poshtë) dhe me dy xhepa diagonal (oblike) në përparëse (pjesa e gjoksit). Në pjesën e sallkisë në kapakët janë vendosur butonat mashkull-femër. Shpina e xhakaventos është e prerë në mes dhe në pjesën e belit rreth 30 cm i vendosen tre llastika me tunel deri në mostër nga ku del një lidhëse në formë kordoni, me nyje në të dyja anët dhe u vendoset nga një kapëse lëvizëse për t'u fiksuar në përdorim. Në pjesën e sipërme të shpinës vendoset supanja e prapme. Tek supet vendoset spalina me material velkro mashkull-femër për montimin e gradave. Materiale të tjera të përshtatshme që përdoren për sigurimin e cilësisë në prodhimin e xhakaventove janë: astar mëndafshi, vatinë, frazelinë, zinxhir konfeksioni etj.

6. *Pulovër*, me fill ngjyrë të errët, cilësia e parë, me përzierje 50 për qind lesh dhe 50 për qind akrilik, methurje trikotazh. Pulovra është jakë "V" dhe bashkë me fundin e mëngëve janë të mbyllura (trikotazh llastik). Mbi supet dhe në bërryla vendosen pjesë tekstili dok terikoton ngjyrë blu për përforcim. Te supet vendoset material velkro mashkull-femër për montimin e gradave.

7. *Doreza me lëkurë natyrale* (shevro keci), cilësia e parë, ngjyrë të zezë. Detajet e dorezave janë të drejta dhe pa dhëmbëzime, ato janë të buta, elastike dhe nuk kanë njolla të ndryshme në ngjyrë. Nga brenda dorezave u vendoset astar pellushi (llutër) që sigurojnë veshjen e ngrohtë të tyre.

8. *Rrip pantallonash me lëkurë natyrale* (telatin), cilësia e parë, ngjyrë të zezë. Rripi është në ato përmasa si në gjatësi e gjerësi që sigurojnë përshtatshmërinë në vendosjen e tij në qemerin e pantallonave. Rripi ka të montuar togëz me një kunj në mes, me material bronzi, i kromuar me derdhje.

Uniforma blu në detyrë (bazë I) stof teritali dhe objektet e tjera që përshkruam më lart përdoren nga policia për të punuar në ambiente, patrullimet në këmbë, makina, ambasada etj.; si rregull në këtë uniformë nuk mbahet armë krahëqafë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

B. UNIFORMA E SHËRBIMIT BAZË II

1. *Veshja për shërbim*, për periudha të ndryshme të vitit, që përfshin: kostum blu (xhaketa, pantallona, kapele tip sport), me tekstil (dok terikoton), i tezgjahur, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, me përzierje 67 ± 3 % poliestër dhe 33 ± 3 % pambuk, me këtë përshkrim:

a) *Xhaketa* është me jakë të hapur me bordurë (muzhik) në të gjithë gjatësinë përpara të përparësës (në anën e vrimave të kopsave) të përshkruara me tegela. Xhaketat kanë dy xhepa pllakë përpara me cepa të prerë nga të dyja anët poshtë, ku xhepi i krahut të majtë është më i madh se xhepi i krahut të djathtë prej 3 cm në gjerësi për të vendosur mjete shkruese dhe nuk mbulohet plotësisht nga kapaku i xhepit. Xhepat janë me kufo në mes dhe me kapak xhepi në formë harqesh në gjoks. Mëngët e gjata janë me kapak. Përparësja e majtë ka pesë vrima, në të cilat montohen kopsa të mëdha korresponduese në anën e djathtë të përparësës. Kopsat janë plastike ngjyrë "ari", me punime artistike, nga brenda ka figurën e shqiponjës së stemës së Policisë së Shtetit e rrethuar me mbishkrimin me germa kapitale fjalët "POLICIA E SHTETIT-SHQIPËRI". Me të njëjtat të dhëna, kopsat e vogla vendosen dhe në kapakët e xhepave. Shpina e xhaketës është e qepur në mes me dopiotegel. Nga përpara, xhaketa në të dyja anët e përparësës dhe në mënyrë të baraslarguar, duke filluar nga buza e qepjes së supit përmes xhepave në kufo e deri në fund, përshkruhet nga një tegel zbukurimi në formë zinxhiri. Në jakat dhe kapat xhepi vendoset ekstrafor. Xhaketa është me mëngë praktike të përdorimit të saj, sipas stinëve dhe shoqërohet me veshje të brendshme, siç janë: bluza pambuku me mëngë të shkurtra e mëngë të gjata. Xhaketës mbi kapakun e xhepit të krahut të majtë i vendoset me qepje mbishkrimi me germa kapitale fjala "POLICIA" me material tekstil fosforeshent ngjyrë të "argjentë" (reflektues). Ky mbishkrim vendoset edhe në bluzat e pambukut në pjesën përpara në anën e majtë të gjoksit dhe në shpinë të bluzave.

b) *Pantallonat* kanë dy xhepa pllakë përpara me cepa të prerë lart, kanë një xhep pllakë të drejtë mbrapa në anën e djathtë. Për të krijuar lehtësi në mbathjen e këpucëve me qafa trupë, pantallonave poshtë për ngushtimin e tyre, i janë qepur material tekstil velkro mashkull-femër.

c) *Kapelja tip sport* është me strehë përpara, që shkon deri 8,5 cm dhe me kapëse plastike me gjashtë pozicione nga mbrapa për përshtatshmërinë gjatë përdorimit, në përputhje me perimetrin e kokës. Në mënyrë të baraslarguar, në të dyja anët e strehës mbi tegelin e qepjes së saj në pjesën ballore vendoset mbishkrimi me germa kapitale fjalët "POLICIA", me material reflektues fosforeshent, ngjyrë të "argjentë".

d) *Rrip mesi i gjerë pantallonash me lëkurë natyrale (telatinë), cilësia e parë, ngjyrë të zezë*. Rrip i është në ato përmasa si në gjatësi e në gjerësi, që sigurojnë përshtatshmëri në vendosjen e tij në qemerin e pantallonave. Në të gjithë gjatësinë e tij në të dyja anët rrip i ka të imituar (stampuar) tegela zbukurimi në formë zinxhiri. Rrip i ka të montuar togëz me dy kunjat, me material bronzi i kromuar me derdhje.

Objekte veshmbathjeje shtesë që vishen me uniformën e shërbimit janë xhakavento sintetike e terikoton, si dhe çizme llastiku. Uniforma e shërbimit mund të përdoret në stinë të ndryshme të vitit dhe si rregull me këtë uniformë mbahet armë. Gjithashtu, kjo uniformë vishet në detyrë shërbimi operativ, kushte të këqija atmosferike etj. dhe në krahun e majtë mbi kapakun e xhepit të xhaketës dhe në bluzat e pambukut vendosen gradat e shërbimit sipas roleve me përmasat: gjatësi 8.6 cm dhe gjerësi 3.0 cm.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

C. VESHJA VERORE (PËR PERIUdhËN 1 PRILL-30 SHTATOR)

1. *Këmisha me mëngë të shkurtra* është me tekstil (puplinë) të tezgjahur ngjyrë bojë qielli, cilësia e parë, me përzierje 67 ± 3 % poliestër dhe 33 ± 3 % pambuk, me këtë përshkrim:

Këmishët janë me jaka të mbyllura, në mënyrë që të mund të përdoret kravatë, me bordurë (muzhik) në të gjithë gjatësinë përpara të përparësës (në anën e vrimave të vendosjes së kopsave) të përshkruara me tegela. Këmishët kanë dy xhepa pllakë përpara me cepa të prerë në të dyja anët poshtë, ku xhepi i krahut të majtë është më i madh se xhepi i krahut të djathtë, prej 3-4 cm në gjerësi për të vendosur mjete shkruese dhe nuk mbulohet plotësisht nga kapaku i xhepit. Xhepat janë me kufo në mes dhe me kapakë xhepi në formë harqesh. Mëngët e shkurtra janë me bordurë (muzhik). Jakat, kapakët e xhepave dhe bordura e mëngës së shkurtër të këmishëve janë me tekstil

(puplinë), ngjyrë blu të errët. Këmishëve në përparësen e djathtë dhe në kapak të xhepave u qepen kopsat e vogla plastike ngjyrë të "artë", me punime artistike. Nga brenda, kopsat kanë figurën e shqiponjës së stemës së Policisë së Shtetit me mbishkrimin me germa kapitale fjalët "POLICIA E SHTETIT - SHQIPËRI". Pjesa e shpinës së këmishës është me supanjë dycopëshe dhe me penca anësore në vijën e qepjes. Nga përpara këmishët, në të dyja anët e përparës dhe në mënyrë të baraslarguar, duke filluar nga buza e qepjes së supit përmes xhepave (në kufo) e deri në fund, përshkruhen nga një tegel zbukurimi në formë zinxhiri. Jakave u vendoset kollaritja e plotë, ndërsa spalina dhe kapakëve të xhepave u vendoset frazelinë.

2. *Pantallonat* janë me tekstil të tezgjahuar, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, me përzierje $67 \pm 3\%$ poliestër dhe $33 \pm 3\%$ viskoz, me këtë përshkrim:

Pantallonat kanë dy xhepa të pjerrët para me fileto 3 mm, kanë një xhep mbrapa me fileto dhe me kapak në formë harku në anën e djathtë. Poshtë xhepave përpara, në rafinë anësore në gjatësinë e pantallonave duke filluar poshtë xhepit vendosen dy fileta, një e kuqe dhe një blu e hapur nga 8-10 mm të gjera secila, të cilat përfaqësojnë ngjyrat e flamurit të Policisë së Shtetit. Pantallonat janë me qemer të gatshëm, në sallki u vendoset për mbërthim zinxhir konfeksioni dhe kapëse metalike.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

D. UNIFORMA E STËRVITJES DHE E KOHËS SË LUFTËS

Specifikimet teknike të uniformës së stërvitjes dhe të kohës së luftës janë të njëjta me specifikimet teknike të uniformës blu të shërbimit bazë II.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

E. UNIFORMA CEREMONIALE

E. Uniforma ceremoniale është e njëjtë si uniforma blu në detyrë bazë I, por duke i shtuar dhe disa elemente, si: këmishë të bardhë, doreza lëkure të bardha, rrip krahqafë të bardhë dhe këpucë gjysma me lëkurë natyrale ngjyrë të zezë, boks viçi (ilustrafin).

Në jakat, mëngët e xhakëtës dhe në rafinë anësore në gjatësinë e pantallonave duke filluar poshtë xhepit vendosen tre shirita, një i kuq, një blu i hapur, që përfaqësojnë ngjyrat e simbolit të flamurit të Policisë së Shtetit, dhe një file të ngjyrë "ari" që ndan të kuqen me blunë. Gjerësia e filetave shkon nga 8-10 mm. Kjo uniformë do të përdoret në raste të veçanta, për festa zyrtare, takime pune, ceremoni etj.

Pelerina është material tekstil i gomuar (pëlhurë impermabël), 100% poliamid, ngjyrë blu të errët, cilësia e parë, me këtë përshkrim: Pelerina kundër shiut është monopet, me dy xhepa false për të nxjerrë duart jashtë dhe me kapuç. Në përparësen e pelerinës (në të dyja anët) vendoset fosforeshent (reflektues, ngjyrë të "argjendtë" 3,5 cm i gjerë dhe 29 cm i gjatë. Për mbërthimin e pelerinës, në pjesën e sallkisë vendosen butona mashkull-femër ose kopsa të mëdha. Në pjesën e shpinës, në mënyrë të baraslarguar nga qepjet anësore poshtë tegelit të qepjes së jakës, vendoset material tekstil shirit fosforeshent (reflektues), ngjyrë e "argjendtë" me përmasat 27,5 cm horizontalisht dhe 10 cm vertikalisht me mbishkrimin me germa kapitale fjalët "POLICIA ". Kapuçi fiksohet me trupin e pelerinës dhe përçark kapuçit vendoset një kordon sintetik, i cili do të ketë dy funksione: kur pelerina vishet, kordoni nëpërmjet dy fiksuesve mbyll pjesën e kapuçit dhe kur pelerina hiqet kordoni përdoret si varëse, ndërkohë që vetë kapuçi do të përdoret si mbështjellës (këllëf) i pelerinës. Nga mbrapa kapuçit (në qendër) deri në të dyja anët e buzëve të kapuçit nga përpara i vendoset shirit fosforeshent (reflektues) ngjyrë të "argjendtë" me gjerësi 3 cm.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

F. KËPUCËT

a) *Këpucë gjysmëdimërore* për përdorim të veshjes së uniformës blu në detyrë bazë I për periudhën 1 tetor-31 mars. Këpucët janë me lëkurë natyrale (boks viçi), ngjyrë të zezë, cilësia e parë, të realizuara në linjë industriale. Kjo këpucë është me qepje brenda dhe jashtë, me fiap të shoqëruar me xhiro gome, me shollë gome të presuar, me relief (kundër rrëshqitjes). Të dhënat organo-leptike për kërkesat për këtë lloj këpucë, që përfshin formën, modelin, mënyrën e punimit, konstruksionin e përgjithshëm të këpucës dhe pjesës së sipërme, faqja, të pjesës së poshtme, sholla nga brenda etj., që janë me referenca të standardeve shqiptare në fuqi (S.Sh), plotësojnë qëllimin e përdorimit të kësaj këpucë nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

b) *Këpucë gjysmëverore* për përdorim të veshjes verore për periudhën 1 prill-30 shtator. Këpucët janë me lëkurë natyrale (boks viçi), ngjyrë të zezë, cilësia e parë, të realizuara në linjë industriale. Kjo këpucë si përsa i përket të dhënave organo-leptike, ashtu dhe përsa i përket treguesve fiziko-mekanikë-kimikë është e njëjtë me atë të këpucës gjysmëdimërore. Ndryshimet janë se këpucët gjysmëverore janë me dy shtresa shollë gome kompakte (pa relief) e bashkuar me ngjitje (pa qepje brenda-jashtë), me fiap gome të presuar të shoqëruar me xhiro gome të presuar (material P.V.C), duke plotësuar në këtë mënyrë qëllimin e përdorimit edhe të kësaj këpuce nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

c) *Këpucë me qafa trupë për përdorim të uniformës së shërbimit* janë me lëkurë natyrale (vaqet tip "U"), ngjyrë të zezë, cilësia e parë, të realizuara në linjë industriale. Kjo këpucë është me qepje brenda dhe jashtë, me fiap të shoqëruar me xhiro gome, me shollë gome të presuar, nga poshtë me llokma (dhëmbëza gomë traktori). Për mbathjen e shpejtë të kësaj këpuce, ajo ka të alternuar vrima dhe ganxha për kalimin e lidhëseve. Për të qenë e rehatshme në përdorim, qafa e këpucës lart nga mbrapa dhe lapeta janë të mbushura me sfungjer. Të dhënat organo-leptike, për kërkesat për këtë lloj këpuce, që përfshin formën, modelin, mënyrën e punimit, konstruksionin e përgjithshëm të këpucës dhe pjesës së sipërme, faqja, të pjesës së poshtme, sholla, nga brenda etj., që janë me referenca të standardeve shqiptare në fuqi (S.Sh), plotësojnë qëllimin e përdorimit të kësaj këpuce nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

PËR SHENJAT E POLICISË SË SHETITIT

1. Shenja për pjesën ballore të kapeles

Forma e shenjës (emblemës) që do të vendoset për përdorim në pjesën ballore të kapeleve të uniformës blu në detyrë bazë I, veshje verore e ceremoniale të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe që përfaqëson stemën e Republikës së Shqipërisë të stilizuar, paraqitet në një masë plastike të posaçme dhe ka këto përmasa:

- Lartësia maksimale, 66 mm;
- Gjerësia maksimale, 55 mm;
- Lartësia maksimale e parzmorës (mburojës), 31 mm;
- Gjerësia maksimale e parzmorës (mburojës), 34 mm;
- Lartësia maksimale e përkrenares së Skënderbeut, 21 mm;
- Gjerësia maksimale e përkrenares së Skënderbeut, 17 mm;
- Lartësia maksimale e shqiponjës, 24 mm;
- Gjatësia maksimale e shqiponjës, 20 mm;

Shenja e kapeles së policisë përbëhet nga këto elemente:

Një kornizë me gjethe floreale (simbol lavdie) në relief, imitim qëndisjeje me ngjyrë "ari" (ngjyrë pushteti dhe triumfi).

Një sfond i brendshëm i bardhë që rrethon një parzmore (mburojë) me kornizë në relief ngjyrë "ari" (reliev në ngjyrë "ari" është imitim qëndisjeje) me trashësi 2 mm dhe me disa pika të zeza të vendosura 10 mm njëra nga tjetra në mënyrë të baraslarguar dhe në brendësi në një sfond të kuq në relief është vendosur një shqiponjë dy krerëshe ngjyrë të zezë. Mbi kornizën horizontale ngjyrë "ari" të pazmores (mburojes) vendoset një sfond ngjyrë blu e errët (ngjyrë karakteristike në përdorimin e veshjes së uniformës së punonjësve të Policisë së Shtetit) në formën gjysmë elipsi, në brendësi të cilit 3 mm mbi kornizën ngjyrë "ari" e mbështetur me bedena (simbol qëndrese) me katër ndarje në ngjyrë të bardhë jo në relief, vendoset në relief përkrenarja e Skënderbeut.

Përmasat e sfondit të shenjës janë: gjerësia 34 mm dhe gjatësia 28 mm.

Të gjitha ngjyrat e brendshme, e bardhë, e kuqe dhe bojë blu janë të punuara me një relief imitim qëndisjeje.

Në shenjë janë të vendosura në mënyrë unike dhe të baraslarguara pesë vrima të vogla, të cilat lejojnë qepjen në kapele. Shenja e kapeles është realizuar në mënyrë specifike dhe, për garantimin e cilësisë, të gjitha elementet e ndërtimit të saj janë me punime e dekoracion, me material plastik me bazë P.V.C. E gjithë shenja mbrohet nga një fletë plastike e tejdukshme, e ngjitur në mënyrë organike në shenjë (të pashqitshme) për ta ruajtur nga oksidimet eventuale që mund të vijnë nga agjentët atmosferikë.

2. Shenja për pjesën e gjoksit të objekteve të uniformës.

Kjo shenjë vendoset për përdorim në anën e majtë të gjoksit mbi kapakun e xhepit të uniformës blu në detyrë bazë I, veshjen verore e ceremoniale të punonjësve të Policisë së Shtetit. Forma e shenjës së gjoksit është një drejtkëndësh me përmasat: gjatësia 8,2 cm dhe gjerësi 1,4 cm. Pjesa e sipërme dhe e poshtme është në rrumbullaksi, të cilat përshtjellojnë nga brenda një karton të posaçëm dhe ngjitet nga mbrapa. Shenja paraqitet në tri ndarje: nga e majta me fushë ngjyrë blu me gjatësi 2,7 cm, në mes ngjyrë "ari" me gjatësi 2,8 cm dhe nga e djathta me fushë ngjyrë të kuqe me gjatësi 2,7 cm. Kjo ndarje realizohet në mënyrë specifike brenda tyre, por ajo që e bashkon atë në një pikë janë dy ngjyrat bazë: blu dhe e kuqe, që përfaqësojnë ngjyrat e simbolit të flamurit të Policisë së Shtetit. Në fushën blu në rolet e tri gradave (të mesëm, të lartë e drejtues) vendoset me ngjitje nga një yll me diametër 14 mm i punuar artistikisht, me vijëzime e gdhendje në drejtim të qendrës dhe me një lidhje të kulmuar në qendër. Në fushën e kuqe, duke shtuar dhe rolin bazë, vendosen me ngjitje elemente që përfaqësojnë gradat në fuqi, siç janë: shirit "ari" në formë këndi për rolin bazë, shirit "ari" gjatësor për rolin e mesëm, dekoracion "ari" (floriale) për rolin e lartë dhe dekoracion ari (murale) për rolin drejtues. Shenja e gjoksit është në reliev me vijëzime me material plastik me bazë P.V.C me termofiksion dhe të mbuluar me veshje mbrojtëse plastike të tejdukshme të pashqitshme. Në anën e pasme të shenjës, në fushën blu dhe në atë të kuqe janë montuar (fiksuar) në trup nga një kunj metalik me majë, në të cilat futet nga një kapsë me veshe për fiksimin e shenjës në përdorimin e objekteve të uniformës.

VENDIM

Nr.239, datë 23.4.2004

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË DISIPLINËS SË GARDËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së disiplinës së Gardës të Republikës së Shqipërisë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

RREGULLORE
E DISIPLINËS SË GARDËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PJESA I
OBJEKTI DHE PËRMBAJTJA E DISIPLINËS

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti

1.1 Rregullorja e disiplinës së Gardës të Republikës është garantimi, respektimi dhe zbatimi i Kushtetutës, i ligjit nr.8869, datë 21.3.2002 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", si dhe i akteve të tjera ligjore e nënligjore që burojnë prej tyre.

1.2 Zbatimi i rregullores së disiplinës bazohet te besnikëria, te detyrimi moral dhe te përgjegjshmëria për kryerjen e detyrave, te respekti në marrëdhëniet ndërmjet punonjësve me grada e funksione të ndryshme në përgjegjësinë vetjake të çdo punonjësi nëpërmjet bindjes dhe detyrimit ligjor për zbatimin e misionit dhe të kryerjes së detyrës.

2. Përmbajtja

2.1 Rregullorja e disiplinës përmban parimet, rregullat e sjelljes, masat ndëshkimore, stimujt materialë e moralë, si dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesat e punonjësve.

2.2 Punonjësit e gardës, në marrëdhëniet ndërmjet tyre janë eprorë dhe vartës. Ndërvartësia përcaktohet nga hierarkia e gradës dhe detyrës.

2.3 Hierarkia e urdhrit është parimi bazë i disiplinës.

2.4 Urdhri është ideja e qartë dhe e përmbledhur e drejtuar vartësve nga eprori me gojë ose me shkrim për kryerjen e një detyre të caktuar.

2.5 Urdhri jepet nga eprori. Ai është përgjegjës për urdhrin e dhënë dhe merr përsipër veprimet, arritjet, dështimet dhe pasojat në zbatim nuk diskutohen, por zbatohen me përpikëri.

2.6 Zbatimi i urdhrit është i detyrueshëm për vartësin. Ai zbaton me përpikëri urdhrin dhe mban përgjegjësi për zbatimin e tij dhe për pasojat që rrjedhin nga moszbatimi.

2.7 Masat motivuese e ndëshkimore kanë për qëllim të ruajnë e të rritin personalitetin, të nxisin iniciativën, të krijojnë lidhje harmonike ndërmjet punonjësve, si dhe të koordinojnë përpjekjet për arritjen e suksesit dhe të qëllimeve të përbashkëta.

2.8 Drejtësia, paanësia e vendosmëria në zbatimin e urdhrit, si dhe ndëshkimi për atë që nuk e zbaton atë janë mjetet kryesore për ruajtjen e forcimit të disiplinës.

2.9 Punonjësi i gardës nuk zbaton urdhrin që bie ndesh me Kushtetutën, ligjin nr.8869, datë 22.5.2005 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", si dhe ligjet e tjera. Për shkaqet e moszbatimit, ai menjëherë njofton urdhërdhënësin dhe në të kundërt në rast mosmarrëveshjes vë në dijeni eprorin direkt më të lartë.

KREU II
DETYRAT E PERSONELIT

3. Detyrat kryesore të personelit

3.1 Njohja me normat e rregullat e sjelljes, ndërgjegjësimi përmes punës bindëse e këshillimit sistematik për përmirësimin në vijimësi të sjelljes në veprimtarinë e tij.

3.2 Vlerësimi dhe kuptimi i shkëljes së kërkesave të disiplinës. Punonjësi në çdo rast informohet nga eprori i tij, për shkëljet e rregullave dhe të normave të disiplinës. Atij i jepet mundësia të shpjegohet dhe të përmirësohet nëpërmjet praktikave bindëse, përveç rasteve të rënda.

3.3 Masat ndëshkimore që jep eprori ndaj vartësit bazohen në fakte e prova bindëse.

3.4 Masat ndëshkimore jepen në mënyrë të shkallëzuar në varësi e në bazë të rëndësisë së shkëljes dhe pasojave që shkaktojnë.

3.5 Punonjësi ka të drejtë të ankohet për masën ndëshkimore të dhënë ndaj tij, kur ai e gjykon se është e padrejtë.

4. Detyrat e punonjësit

4.1 Të njohë e të zbatojë me korrektësi detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta, ligji nr. 8869, datë 22.5.2005 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore që normojnë misionin dhe detyrën që kryen.

4.2 Të jetë besnik ndaj interesave të atdheut e të kombit dhe të ruajë me fanatizëm sekretin e detyrës. Të denoncojë çdo veprim që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin nr. 8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".

4.3 Të mbajë kurdoherë lart nderin dhe dinjitetin e gardistit, si dhe të tregojë respekt e profesionalizëm ndaj rregullave e normave në kryerjen e detyrës.

4.4 Të ruajë e të përmirësojë në vijimësi njohuritë profesionale dhe aftësitë për kryerjen me cilësi të detyrave.

4.5 Të shmangë çdo marrëdhënie apo shoqëri me individë ose grup individësh që paraqesin ose përbëjnë rrezik dhe pengojnë në kryerjen e detyrës.

4.6 Të paraqitet rregullisht në detyrë, të mirëmbajë uniformën (veshjen) e përcaktuar sipas normës, armatimin dhe mjetet teknike të posaçme e pajisjet.

5. Detyrat e eprorit

5.1 Eprori është autoriteti që i jep urdhër vartësit direkt ose të komanduar në vartësi dhe përgjigjet për disiplinën e personelit në vartësi.

5.2 Të punojë dhe të ushtrojë autoritetin e vazhdueshëm të disiplinës, duke vënë në veprim të gjitha aftësitë profesionale, fizike e mendore.

5.3 Të përdorë dhe të ushtrojë autoritetin e gradës e të funksionit vetëm në shërbim të detyrës.

5.4 Të respektojë profesionalizmin e vartësve, të drejtat dhe dinjitetin e tyre.

5.4 Të dëgjojë me vëmendje çdo sugjerim e çdo propozim që bëhet në funksion të detyrës.

5.5 Të trajtojë me objektivitet e paanësi ankimet e vartësve dhe të silltet në mënyrë shembullore, duke drejtuar e vepruar me shembullin personal.

6. Detyrat e vartësit

6.1 Vartësi është punonjësi me gradë me funksion më të ulët, zbatues i urdhrit të eprorit.

6.2 Të nderojë, të respektojë dhe t'u bindet eprorëve për urdhrat e detyrat që i ngarkohen.

6.3 Të zbatojë me përpikëri detyrimet që rrjedhin nga vendi që zë në hierarkinë e gradave dhe nga vendimet e marra në procesin e zbatimit të detyrës.

6.4 Të tregohet kurdoherë i vëmendshëm e i gatshëm për marrjen dhe për zbatimin e urdhrave e të detyrave.

6.5 Të respektojë me korrektësi kërkesat dhe normat e disiplinës që rregullojnë veprimtarinë në procesin e zbatimit të detyrave.

7. Detyrat e veçanta

7.1 Punonjësi i gardës, nga momenti i hyrjes në shërbim në strukturat e Gardës së Republikës të Shqipërisë, në çdo rrethanë, nuk duhet të silltet dhe të mbajë qëndrime, të cilat cenojnë natyrën e depolitizuar të gardës.

7.2 Punonjësit të gardës i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive, shoqatave politike apo kandidatëve në zgjedhje.

7.3 Punonjësi i gardës nuk mund të dypunësohet ose të kryejë veprimtari private.

7.4 Punonjësve të gardës u ndalohet të organizohen në sindikata dhe të ushtrojnë të drejtën e grevës, si dhe të bëjnë grumbullime.

7.5 Detyrë parësore e disiplinës është ruajtja e dinjitetit dhe e nderit personal të punonjësit të Gardës, nëpërmjet tipareve dhe cilësive dalluese.

7.6 Sjellje etike dhe ligjore në detyrë.

7.7 Qëndrim i vendosur dhe korrektësi në zbatimin e ligjit.

7.8 Paraqitje e jashtme e rregullt dhe prezantim dinjitoz në detyrë e publik.

7.9 Aftësi komunikimi me kulturë dhe me edukatë me vartësit, me eprorët e me publikun.

7.10 Profesionalizëm në detyrë, përgatitje e kualifikim i vazhdueshëm.

PJESA II
STIMUJT MOTIVUES DHE MASAT NDËSHKIMORE

KREU I
FALËNDERIMET, SHPËRBLIMET DHE KOMPETENCAT PËR DHËNIEN E
TYRE

8. Falënderimet dhe shpërblimet

8.1 Falënderimet e shpërblimet janë stimuj vlerësues dhe nxitës në veprimtarinë e Gardës së Republikës të Shqipërisë, të cilat përdoren në rastet e përmbushjes me cilësi e me disiplinë të lartë të misionit apo detyrës.

8.2 Në Gardën e Republikës së Shqipërisë jepen këto falënderime e shpërblime:

- a) falënderime;
- b) heqje të masës disiplinore të dhënë më parë;
- c) vendosje e fotografisë personale para flamurit të gardës;
- ç) leje të veçantë;
- d) Shpërblim në lekë deri në masën e 8 pagave mujore në vit;
- dh) gradim jashtë radhe;
- e) dekorim.

8.3 Falënderimet e shpërblimet jepen nga eprori në këto raste:

- a) Për plotësim shembullor dhe me përkushtim të detyrës;
- b) Për veprime guximi, për akte trimërie dhe për sakrificë në ruajtjen dhe mbrojtjen e PLSH-ve dhe ORV-ve;
- c) Për rezultate të larta në stërvitje e gatishmëri;
- ç) Për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale e monetare.

8.4 Falënderimet dhe shpërblimet jepen duke zbatuar procedurat hierarkike, sipas propozimeve me shkrim për llojin dhe motivacionin përkatës.

8.5 Falënderimet dhe shpërblimet komunikohen direkt dhe regjistrohen në librin e praktikës disiplinore e në dosjen personale të punonjësit.

9. Kompetencat për dhënie e falënderimeve dhe shpërblimeve

9.1 Dhëniet e falënderimeve dhe shpërblimeve përcaktohen nga niveli i komandimit e i drejtimit. Nivelet e komandimit e të drejtimit për dhënie e tyre janë si më poshtë:

- Komandanti i nëngrupit:
- Falënderim;
- Heqje të masës disiplinore të dhënë më parë.
- Komandanti i grupit shoqërues:
- Falënderim për gardistët dhe nënoficerët;
- Heqje të masës disiplinore të dhënë më parë;
- Propozon leje të veçantë.
- Komandanti i nënnjësisë, përgjegjës eskorte, shef zyre:
- Falënderim për gardistët dhe nënoficerët;
- Heqje të masës disiplinore të dhënë më parë;
- Propozon leje të veçantë;
- Leje të veçantë deri në tri ditë.
- Komandanti i njësisë, shef sektori:
- Falënderim për gardistët dhe nënoficerët;
- Heqje të masës disiplinore të dhënë më parë;
- Leje të veçantë deri në 5 ditë;
- Propozon për vendosjen e fotografisë personale para flamurit të gardës;
- Propozon dhënie "Shpërblimi në lekë" për punonjësit në vartësi;
- Propozon "Gradim jashtë radhe" të nënoficerit.
- Drejtori:
- Falënderim për gardistët dhe nënoficerët;

- Heqje të masës disiplinore të dhënë më parë;
- Leje të veçantë deri në 5 ditë;
- Propozon për gardistin, vendosjen e fotografisë personale para flamurit të gardës;
- Propozon dhënie "Shpërblimi në lekë" për punonjës në vartësi;
- Propozon "Gradim jashtë rradhe" të nënoficerit dhe oficerit.
- Komandanti i Gardës së Republikës:
- Falënderim për gardistët dhe nënoficerët;
- Heqje të masës disiplinore të dhënë më parë;
- Leje të veçantë deri në 7 ditë;
- Vendosjen e fotografisë personale para flamurit të gardës për punonjës;
- Jep shpërblim në lekë për punonjës deri në 4 paga mujore;
- Propozon "Gradim jashtë rradhe" të nënoficerit dhe oficerit;
- Propozon "Dekorim" për punonjës.

9.2 Funksionet e fushave të tjera të interesit gjatë ushtrimit të detyrës kanë të drejtën e propozimit të kompetencave në një shkallë më të ulët se kompetencat e eprorëve të tyre direkt e më të afërt.

KREU II

MASAT NDËSHKIMORE DHE KOMPETENCAT PËR DHËNIEN E TYRE

10. Masat ndëshkuese

10.1 Masat ndëshkimore kanë karakter parandalues, edukues, të cilat ndikojnë në forcimin e disiplinës. Ato jepen në përputhje me ligjin nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".

10.2 Masat ndëshkimore jepen nga eprori më i afërt dhe nga eprorët e tjerë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së drejtpërdrejtë ose me propozim, në bazë të hierarkisë së detyrave.

10.3 Masat ndëshkimore trajtohen shpejt, duke zbatuar rregullin, që për një shkelje disiplinore nuk jepet më tepër se një ndëshkim disiplinor.

10.4 Eprori i përdor masat ndëshkimore si veprime të domosdoshme për forcimin e disiplinës. Ai e vlerëson dhënien e tyre si një të drejtë dhe detyrë.

10.5 Masat ndëshkimore jepen në mënyrë të shkallëzuar në përputhje me shkallën e shkeljes dhe të pasojave që shkaktojnë.

10.6 Kur shkelja ka të bëjë me dëmtime materiale, dëmi i shkaktuar zhdëmtohet sipas akteve normative dhe jo si efekt shoqërues i masës disiplinore.

10.7 Masa ndëshkimore jepet në prani fizike të personit të ndëshkuar. Komunikimi i masës disiplinore bëhet për nënoficerët në prani të personelit nënoficer, ndërsa për oficerët në prani të personelit oficer të të njëjtit nivel komandimi dhe më të lartë.

10.8 Masat ndëshkimore komunikohen dhe regjistrohen në librat e praktikës disiplinore e në dosjen personale të punonjësit.

10.9 Për shkeljet e kryera nga punonjësi, të cilat lidhen me detyrën, kur këto nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen në bazë të nenit 16 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me masat ndëshkimore si më poshtë:

- vërejtje;
- vërejtje me paralajmërim;
- gjobë në masën e pagës deri 5 ditë-pune;
- shtyrje të afatit të gradimit deri në një vit;
- ulje në detyrë ose në funksion;
- pezullim nga detyra ose nga funksioni deri në tre muaj ose deri në përfundimin e çështjes penale;
- përjashtim nga garda e lirim.

11. Kriteret për dhënien e masave ndëshkimore

11.1 Niveli i komandimit dhe i drejtimit për dhënien e masave ndëshkimore zbaton kriteret e parashikuara sa më poshtë:

- Vërejtja është një masë këshilluese e korigjuese, që i jepet vartësit për rastet e keqsjelljeve në punë, të parregullsisë në mbajtjen e uniformës, të plogështisë dhe të indiferentizmit në zbatimin e urdhrave dhe detyrave të ngarkuara.

- Vërejtja me paralajmërim jepet në rastet e përsëritjeve të shkeljeve disiplinore, kur për to është dhënë masa "vërejtje", në mungesa në punë dhe sjellje jokorrekte në kryerjen e detyrave, mosinformim i eprorit në kohën e duhur për probleme të ndryshme dhe mungesa të konstatuara para fillimit apo gjatë kryerjes së detyrës, parregullsi në kryerjen e shërbimit, sjellje jokorrekte e fyese ndaj punonjësve me gradë e me funksion më të lartë, kolegëve, vartësve apo publikut.

Masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim" administrohet në dosjen personale të punonjësit.

- Gjoha në masën e pagës deri në 5 ditë konsiston në reduktimin e pagës mujore të punonjësit dhe jepet në rastet, si: të përsëritjeve të shkeljeve të ndëshkuara më parë me "vërejtje me paralajmërim", në paraqitje me vonesë në detyrë në mënyrë të përsëritur, në mosparaqitje të justifikuar në detyrë deri në dy ditë, në pakujdesi dhe moskorrektësi në zbatimin e urdhrit.

- Shtyrja e afatit të gradimit deri në një vit, jepet në rastet e përsëritjeve të shkeljeve të ndëshkuara më parë me "gjobë në masën deri në 5 ditë-punë", neglizhenca të përsëritura në zbatimin e urdhrave e të detyrës, të metave dhe të dobësive të vazhdueshme gjatë kryerjes së detyrës, mos informimi dhe komunikimi në mënyrë të pasaktë të urdhrit që sjell cenimin e kryerjes së detyrave, dhënie urdhri që nuk i përket shërbimit apo disiplinës dhe që tejkalojnë kompetencat, mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga etika e punonjësit të gardës.

- Ulja në detyrë ose funksion jepet në rastet e përsëritjeve të shkeljeve të ndëshkuara më parë me "shtyrje të afatit të gradimit deri në një vit, shkelje që fyejnë dinjitetin e funksionit, shkelje që cenojnë zbatimin e detyrimeve ndaj vartësve, paaftësi në punën drejtuese që kanë të bëjnë me kujdesin për plotësimin e kushteve materiale e jetësore për vartësin, sipas normave, në ushtrimin e kontrollit mbi zbatimin e detyrave dhe sjelljen e vartësve, në pakujdesi për ruajtjen e vlerave materiale.

- Pezullimi nga detyra ose funksioni deri në tre muaj ose në përfundim të çështjes penale konsiston në largimin nga shërbimi (detyra) të punonjësit për periudhën kohore të përcaktuar deri në tre muaj për rastet e përsëritjeve të shkeljeve të disiplinës, për të cilat është dhënë një herë masa e "uljes në detyrë ose funksion" apo "shtyrje e afatit të gradimit deri në një vit", mbajtje të lidhjeve me persona me rrezikshmëri shoqërore ose që sillen në kundërshtim me normat e moralit shoqëror.

Mosparaqitje ose paraqitje me vonesë në punë për një periudhë kohe mbi 48 orë dhe jo më shumë se shtatë ditë, si dhe pezullim deri në përfundim të çështjes penale në ngarkim të punonjësit.

Masa e pezullimit jepet sipas rastit nga komandanti i gardës, për punonjësit e nivelit të ulët e të mesëm dhe nga Ministri i Rendit Publik, për punonjësit e nivelit të lartë e madhor.

- Përfashtimi nga garda e lirimi konsiston në largimin e punonjësit përgjithmonë nga funksionet e detyrat në Gardën e Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesave të ligjit "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë" të parashikuara në nenin 14 pika "2", si kryerje në mënyrë të përsëritur të thyerjes së disiplinës, mosparaqitje në detyrë pa shkaqe të arsyeshme mbi 7 ditë, shkelje të betimit, kur dënohet penalisht.

11.2 Kompetencat sipas niveleve të komandimit e të drejtimit për dhënien e masave ndëshkimore.

- Komandanti i nëngrupit:

- Vërejtje.

- Komandanti i grupit, komandanti i grupit shoqërues:

Vërejtje;

- Propozon për "Vërejtje me paralajmërim".

- Komandanti i nënnjesisë, përgjegjës eskorte, shef zyre:

- Vërejtje;

- Propozon për "Vërejtje me paralajmërim" për oficerët.

- Jep "Vërejtje me paralajmërim" për nënoficerin.

- Komandanti i njesisë, kryetar dege, shef sektori:

- Vërejtje;

- Jep "Vërejtje me paralajmërim" për oficerët dhe nënoficerët;
 - Propozon "gjobë deri në 5 ditë" për punonjës në vartësi;
 - Propozon "shtyrje të afatit të gradimit" për punonjës në vartësi;
 - Propozon "ulje në detyrë e në funksion" për punonjës në vartësi.
 - Drejtori:
 - Vërejtje;
 - Jep "Vërejtje me paralajmërim" për oficerët dhe nënoficerët;
 - Propozon "gjobë deri në 5 ditë" për punonjës në vartësi;
 - Propozon "shtyrje të afatit të gradimit" për punonjës në vartësi;
 - Propozon "ulje në detyrë e në funksion" për punonjës në vartësi;
 - Vendos "gjobë" në masën e pagës deri në 3 ditë.
 - Komandanti i gardës:
 - Jep të gjitha masat ndëshkimore të parashikuara për nivelet komanduese;
 - Jep "gjobë në masën e pagës deri në 5 ditë";
 - Shtyn afatin e gradimit deri në një vit për oficerin e emërtesës së tij;
 - Shkarkon nga detyra punonjës në nivelin të mesëm, që janë në emërtesë të tij;
 - Jep masën "lirim" për nënoficerin;
 - Propozon "shkarkim nga detyra të oficerëve të nivelit të lartë";
 - Jep masën "pezullim nga detyra e nga funksioni" për oficerët e nivelit të ulët, të mesëm e të lartë dhe propozon për punonjës në nivelin madhor;
 - Propozon masën "lirim" për punonjës në nivelin të mesëm e të lartë dhe madhor.
 - Ministri i Rendit Publik:
 - Të gjitha masat ndëshkimore të parashikuara në këtë rregullore;
 - Propozon masat "shkarkim nga detyra" dhe "pezullim nga detyra ose nga funksioni" të oficerit madhor;
 - Jep masat "shkarkim nga detyra" dhe "lirim" për punonjës në nivelin të lartë.
- 11.3 Funksionet e fushave të tjera të interesit gjatë ushtrimit të detyrës kanë të drejtën e propozimit për masat ndëshkimore në një shkallë më të ulët se kompetencat e eprorëve të tyre direkt e më të afërt.

KREU III

PROCEDURA PËR DHËNIEN E MASAVE NDËSHKIMORE DHE MËNYRA E ANKIMIT

12. Procedurat që zbatohen për dhënie e masave.

12.1 Autoriteti apo propozuesi për dhënie e masës disiplinore përgatit raport me shkrim mbi shkeljen e disiplinës të kryer nga punonjësi.

12.2 Shkelja dhe njoftimi për raportin e hartuar i komunikohet nga autoriteti disiplinor personit që ka shkelur disiplinën, duke kërkuar prej tij shpjegime të duhura, të cilat duhet të evidentohen.

12.3 Autoriteti disiplinor, kur e gjykon të nevojshme, bën verifikime e saktësime për shkeljen e konstatuar. Në rast se ai e konstaton vetë shkeljen, jep masën disiplinore, duke i kërkuar eprorit direkt ose me të afërt të shkelësit të kryejë procedurat përkatëse.

12.4 Për dhënie e masës disiplinore, eprori mban parasysh rrethanat e ngjarjes, sjelljen dhe shkeljet disiplinore të mëparshme të punonjës, si dhe pasojat që vijnë nga shkelja.

12.5 Masa disiplinore i komunikohet punonjës nga eprori direkt i tij, jo më vonë se 5 ditë pas dhënies së saj.

12.6 Eprori në secilin nivel komandimi e drejtimi mbikëqyr vartësit në ushtrimin e të drejtës për masat ndëshkimore dhe për forcimin e disiplinës.

12.7 Masa disiplinore evidentohet në dosjen personale të punonjës me përfundimin e afatit të ankimit, ndërsa zbatimi i ndëshkimit fillon nga momenti i komunikimit të masës disiplinore.

13. Mënyra e ankimit

13.1 Punonjësi i ndëshkuar me masë disiplinore ka të drejtë të ankohet brenda 5 ditëve në nivelin më të lartë të komandimit e të drejtimit dhe brenda 10 ditëve në komisionin disiplinor. Ankesa e ushtruar jashtë afatit pa shkaqe të justifikuara nuk merret në shqyrtim. Afati i ankimit fillon që nga data e komunikimit të masës disiplinore.

13.2 Ankimet bëhen në mënyrë individuale dhe me shkrim. Nuk lejohen ankimet kolektive. Ato përbëjnë shkelje më vete të disiplinës.

13.3 Punonjësi që ka bërë ankesë për masën disiplinore, mund ta tërheqë atë në çdo kohë. Tërheqja e ankesës bëhet me shkrim dhe e nënshkruar prej tij.

14. Komisioni disiplinor

14.1 Komisioni i disiplinës është organ i brendshëm, i cili shqyrton ankimin e punonjësit të ndëshkuar me masë ndëshkimore.

14.2 Përbërja dhe funksionimi i komisionit disiplinor përcaktohet me urdhër të veçantë të Ministrit të Rendit Publik.

14.3 Komisioni disiplinor i zhvillon mbledhjet e tij me pjesëmarrjen e plotë ose jo më pak se 3/4 e anëtarëve të tij. Vendimet e komisionit disiplinor merren me shumicë votash.

14.4 Përfshihen nga pjesëmarrja në mbledhjen e komisionit anëtarët të cilët janë palë e interesuar për çështjen që merret në shqyrtim. Nëse është e nevojshme në mbledhjen e komisionit mund të thirren për t'u dëgjuar ankuesi ose persona të tjerë të cilët kanë dijeni apo lidhje me shkeljen e kryer.

14.5 Komisioni disiplinor merr në shqyrtim kërkesën e ankuesit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes dhe brenda 3 ditëve i kthen përgjigje me shkrim ankuesit dhe autoritetit ndëshkues mbi vendimin e marrë.

14.6 Përgatitja e materialeve të nevojshme për mbledhjen e komisionit disiplinor, si dhe njoftimet e anëtarëve, kryhen nga shefi i personelit të gardës.

14.7 Për administrimin e kërkesave, procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, vendimeve të dhëna nga komisioni, si dhe materialeve të tjera që kanë të bëjnë me komisionin disiplinor, krijohen regjistra të veçantë në degën e personelit të gardës.

KREU IV

PAVLEFSHMERIA DHE SHUARJA E MASAVE DISIPLINORE

15. Pavlefshmëria

15.1 Masa disiplinore humbet dhe nuk mund të jepet kur nga koha e kryejes së saj kanë kaluar 6 muaj dhe 1 muaj nga dita e konstatimit.

15.2 Kur masa disiplinore nuk i komunikohet punonjësit të ndëshkuar brenda 1 muaji nga momenti që është dhënë.

15.3 Tejkallim të kompetencës në dhënien e masës disiplinore.

15.4 Dhënie të masës disiplinore që nuk është parashikuar në ligj.

15.4 Mosrespektim të fazave të shqyrtimit të masës disiplinore.

15.4 Mungesë të provave e fakteve për shkeljen disiplinore.

16. Shuarja e masave disiplinore

16.1 Masat disiplinore të dhëna shuhen në këto raste:

- Vërejtje me paralajmërim me kalimin e 6 muajve nga data e dhënies së saj.
- Masat disiplinore përveç masës "përfshihen nga garda" dhe "nxjerrje në lirim", me kalimin e një viti nga data e dhënies së tyre.
- Me vendimin e pushimit të çështjes penale të filluar apo pafajësisë së dhënë nga gjykata për rastet e pezullimit.
- Masa disiplinore e ankimuar nga koha kur vendimi i autoritetit ka marrë formën e prerë.

KREU V
RREGULLA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

17. Në zbatim të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", për gardistët për periudhën e kalimit nga shërbim i detyrueshëm ushtarak në sistemin profesionist, zbatohen masat ndëshkimore sipas rregullores së shërbimit ushtarak të Forcave të Armatosura.

18. Gjatë periudhës me masë ndëshkimore punonjësit i ndërpriten të drejtat e parashikuara për punonjësit e gardës, me përjashtim të vjetërsisë në shërbim. Ndërsa në raste të veçanta, kur i ndëshkuari kryen akte përkushtimi në detyrë heqja e masës ndëshkimore bëhet para afatit.

19. Të gjitha rregulloret dhe procedurat e mëparshme, që bien ndesh me ligjin nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë" dhe me këtë rregullore, shfuqizohen.

20. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.241, datë 23.4.2004

**PËR NJË NDRYSHIM E SHITESË NË VENDIMIN NR.81, DATË 6.2.2003 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE "PËR SHITJE TRUALLI KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË
SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 3 shkronja "b" dhe 8 paragrafi i parë të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimi nr.81, datë 6.2.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim e kjo shtesë:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:


"1. Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë i shitet trualli me sipërfaqe prej 1079 m², në pjesën lindore të pronës së kësaj kishe, në qytetin e Tiranës, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi."

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1.Të ardhurat, që realizohen nga shitja e truallit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të derdhen në Buxhetin e Shtetit."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



VENDIM
Nr.242, datë 16.4.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.315, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSIT CIVIL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat e mëposhtme:

Pas pikës 9 të shtohen pikat 9/1, 9/2, 9/3 dhe 9/4 me këtë përmbajtje:

“9/1. Për zhvillimin e trajnimeve, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), lidh me referuesit (trajnerët) një apo disa nga tipet e këtyre kontratave:

- a) Kontratë për trajnimin e referuesve;
- b) Kontratë për trajnimin e nëpunësve të administratës publike;
- c) Kontratë për hartimin e kurrikulave dhe të materialeve të tjera trajnuese.

9/2. a) Tarifat e pagesës për referuesit (trajnerët) përcaktohen në kontratë dhe llogariten në bazë ditore, në varësi të kategorisë së referuesit (trajnerit).

b) Për kontratat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 9/1, tarifa ditore e plotë të paguhet për zhvillimin e 6 orëve trajnim, sipas tabelës nr.1 të lidhjes, që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Për kontratat e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 9/1, tarifa ditore e plotë të paguhet për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve trajnim, sipas tabelës nr.2 të lidhjes, që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, apo të trajnimit për më pak se 6 orë trajnim, pagesa të llogaritet në përpjestim me orët e trajnimit.

9/3. Referuesit (trajnerët) ndahen në tri kategori, si më poshtë vijon:

a) Referues (trajnerë) të kategorisë së ulët janë referuesit, të cilët kanë deri në pesë vjet përvojë pune në fushën përkatëse.

b) Referues (trajnerë) të kategorisë së mesme janë referuesit, të cilët kanë një përvojë pune nga 5 deri në 10 vjet në fushën përkatëse ose kanë një diplomë master a të barasvlefshme me të.

c) Referues (trajnerë) të kategorisë së lartë janë referuesit, të cilët kanë mbi 10 vjet përvojë pune në fushën përkatëse ose kanë një gradë shkencore.

9/4. Shpenzimet për realizimin e trajnimeve të mbulohen nga buxheti i miratuar për Institutin e Trajnimit të Administratës Publike.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA A

Tarifat e pagesave për referuesit (trajnerët)

Tabela nr.1

Kategoria e referuesve (trajnerëve)	Tarifat ditore/lekë
I ulët	4500
I mesëm	6000
I lartë	9000

Tabela nr.2

Kategoria e referuesve (trajnerëve)	Tarifat ditore/lekë
I ulët	7200
I mesëm	9000
I lartë	13 000

VENDIM

Nr.243, datë 26.3.2004

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET BUXHETORE PËR VITIN 2004 DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2004, në ministrinë dhe institucionet buxhetore, të jetë sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave të paraqesin, brenda muajit maj 2004 në Këshillin e Ministrave materialin për ristrukturimin e plotë të numrit të punonjësve në institucionet buxhetore.

3. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri “Paga dhe sigurime shoqërore”, t’i shtohen 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, të cilat t’i pakësohen buxhetit të vitit 2004, zëri “Paga dhe sigurime shoqërore”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave, për shkak të ndryshimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve në këto dy institucione.

4. Ngarkohen ministrat dhe drejtuesit e institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja 1. Numri i punonjesve buxhetore per vitin 2004

Ministria/Institucioni qendror	Nr.Punonjesve 01janar - 30prill	Nr.Punonjesve 01maj - 31dhjetor
Presidenca	66	66
Kuvendi	407	407
Keshilli i Ministrave	305	305
Ministria e Integrimit	72	72
Ministria e Industrise dhe Energjitikes	398	390
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit	1,300	1,300
Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit	410	440
Ministria e Ekonomise	210	210
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	1,260	1,250
Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	242	242
Ministria e Financave	455	455
Ministria e Arsimit dhe Shkences	44,300	44,000
Ministria e Kultures, Rinise e Sporteve	1,120	1,120
Ministria e Shendetesise	21,400	21,250
Ministria e Drejtesise	2,260	2,672
Ministria e Puneve te Jashtme	177	186
Ministria e Rendit Publik	13,745	13,468
Ministria e Mbrojtjes	9,000	9,000
Sherbimi Informativ Shteteror	1,400	1,400
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	120	120
Drejtoria e Rezervave te Shtetit	300	285
Akademia e Shkencave	620	620
Kontrolli i Larte i Shtetit	150	150
Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale	1,397	1,405
Ministria e Mjedisit	100	100
Agjensia Kombetare e Privatizimit	55	55
Prokuroria e Pergjithshme	760	760
Pushteti Gjyqesor	1,140	1,140
Gjykata Kushtetuese	30	30
Agjensia Telegrafike Shqiptare	118	118
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	2,165	2,165
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	1,050	1,050
Drejtoria e Pergjithshme e Standarteve	25	22
Drejtoria e Pergjithshme e Pyjeve dhe Kullotave	1,050	1,020
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	1,520	1,520
Instituti i Statistikes	155	155
Enti Kombetar i Zonave te Lira	7	7
Shkolla e Magjistratures	17	17
Qendra Kombetare e Kinematografise	10	10
Instituti i Integrimit te Ish-te perndjekurve politike	50	50
Keshilli i Larte i Drejtesise	34	34
Avokati i Popullit	45	45
Komisioni i Sherbimit Civil	28	28
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	60
Avokati i Shtetit	60	60
Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive	30	30
Autoriteti i Konkurrences	15	15
Totali	109,638	109,304

VENDIM
Nr.244, datë 23.4.2004

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT DHE TË SKEMËS SË FURNIZIMIT ME
KARBURANT PA AKCIZË, PËR PËRCAKTIMIN E SASIVË TË KARBURANTIT, QË DO
TË PËRDOREN PËR MEKANIKËN BUJQËSORE NË TRI ZONA TË VENDIT DHE PËR
SERAT ME NGROHJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fermerët që kryejnë punime bujqësore të mekanizuara në bujqësi, të përfshirë në zonat: Sarandë-Delvinë, Fier-Divjakë dhe Fushë-Krujë-Lezhë të furnizohen me karburant e lubrifikant pa akcizë.

2. Armo sh.a. t’i furnizojë këto zona me 8 400 ton gazoil dhe 252 ton vajra lubrifikant pa akcizë, për plotësimin e nevojave të fermerëve, që përfitojnë nga ky vendim, për periudhën maj 2004-korrik 2005.

3. Të gjitha subjektet private në të gjithë vendin, që kultivojnë kultura bujqësore në sera me ngrohje, të furnizohen me 3 000 ton naftë dhe 2 000 tonë solar pa akcizë.

4. Fondet kundërparti në shumën 195 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekë, të realizuara nga shitja e mallrave të ardhura në kuadër të projektit grant të Qeverisë japoneze, si mbështetje buxhetore, të përdoren për mbështetjen e këtij projekti pilot, si më poshtë vijon:

- 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë, të cilat të kalojnë nga llogaritë respektive të Bankës së Shqipërisë në llogaritë respektive të projektit “2KR”, për kreditimin me afat të shkurtër kohor të përfituesve nga ky vendim, për blerjen e karburantit, të lubrifikantit dhe lëndës djegëse nga ARMO, sh.a.

- 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, të cilat të kalojnë nga llogaritë respektive të Bankës së Shqipërisë në llogaritë respektive të projektit “2KR” për kreditimin me afat të mesëm kohor pa interes të subjekteve private të agromenakizatorëve, që veprojnë në zonat e përfshira në projektin pilot, për furnizimin e këtyre subjekteve me pajisje matëse, transporti dhe ruajtjeje të karburantit.

5. Procedurat e përdorimit të këtyre fondeve të bëhen sipas marrëveshjeve të nënshkruara me Qeverinë japoneze, sipas përcaktimeve të vendimeve nr.148, datë 31.3.2000 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Japonia, në kuadër të projektit “Shtimi i prodhimeve ushqimore”, 2KR” e nr.485, datë 21.10.1999 “Për miratimin e shpërndarjes së fondeve të dhëna nga Qeveria e Japonisë, si mbështetje buxhetore për përballimin e situatës së krijuar për shkak të krizës në Kosovë” të Këshillit të Ministrave, si dhe udhëzimeve të përbashkëta të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Ministrit të Financave.

6. Procedurat e zbatimit të këtij projekti pilot dhe skemat e shpërndarjes së karburantit caktohen me një udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

7. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.245, datë 16.4.2004

**PËR NJË SHITESË FONDI MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË
DECENTRALIZIMIT PËR INFORMATIZIMIN E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë financimin e informatizimit të shërbimit të gjendjes civile nga Buxheti i Shtetit në shumën 840 000 000 (tetëqind e dyzet milionë) lekësh.
 2. Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit në buxhetin e miratuar për vitin 2004 t’i shtohet fondi prej 301 500 000 (treqind e një milion e pesëqind mijë) lekësh, i ndarë si më poshtë vijon:
 - 300 000 000 (treqind milionë) lekë, për fazën e parë të informatizimit të shërbimit të gjendjes civile, e cila do të kryhet në vitin 2004.
 - 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, për njoftimin e ftesës për ofertë në një gazetë ndërkombëtare, për këtë fazë.
 3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 4. Fazat e dytë e informatizimit të shërbimit të gjendjes civile do të financohet nga Buxheti i Shtetit për vitin 2005.
 5. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.246, datë 18.3.2004

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË DECENTRALIZIMIT
TË PËRDORË PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR
SHTYPSHKRIMIN E CERTIFIKATAVE TË GJENDJES CIVILE, ME ELEMENTE
SIGURIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit që, për fondin e vet prej 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekësh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” me shoqërinë “Edlor” sh.p.k. për shtypshkrimin e certifikatave të gjendjes civile, me elemente sigurie.
 2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 247, datë 23.4.2004

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT DHE
TË REFORMËS INSTITUCIONALE NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË
KULLOTAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit dhe të reformës institucionale në sektorin e pyjeve dhe të kullotave në Republikën e Shqipërisë.

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Mjedisit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004
--

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 10.5.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë